



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1794/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Vjollca Shyti, përfaqësuese ligjore në Komunën e Gjakovës, kundër debitorit Ndërmarrja private “P...”, me seli në Gjakovë, drejtor P.M. , të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Prek Kola, avokat në Gjakovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.10/2022 të datës 17.01.2022, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 29.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Ndërmarrja private “P...”, me seli në Gjakovë, i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.10/2022 të datës 17.01.2022, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri P.nr. 10/2022 i datës 17.01.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Gjakovës, në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.207/17 të datës 23.10.2018, ka nxjerr urdhrin P.nr.10/2022 të datës 17.01.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit Ndërmarrja private “P...”, me seli në Gjakovë, duke e detyruar debitorin që kreditorit të ia paguaj borxhin prej 7,320.00 €, me kamatë përkatëse ligjore siç e paguajnë bankat komerciale në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 23.10.2018 e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 100 €, ashtu që detyrimet të realizohen

përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare dhe bartjen e tyre në llogari të veçantë bankare të Përmbaruesit Privat.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri për përmbarim është i pa bazuar dhe kundërligjor, borxhi i debitorit nuk ekziston dhe se kërkesa është parashkruar në vështrim të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjithashtu ka shtuar se është paraqitur revizioni si mjet të jashtëzakonshëm dhe se ende nuk ka përfunduar procedura me mjete të jashtëzakonshme të ankimimit, andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar, dhe të vihet jashtë fuqie urdhri përmbarimor si dhe të revokohen të gjitha veprimet përmbarimore.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se të njëjtat janë të pabazuara, duke shtuar se mjete jashtëzakonshëm në këtë rast revizioni nuk e ndalon ekzekutimin e aktgjykimit, po ashtu edhe faktin se është nxjerrë aktgjykim i Gjykatës Supreme, ku i është refuzuar si i pabazuar revizioni i debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa themeltë prapësimi i debitorit, i ushtruar kundër urdhrin të përmbaruesit Privat Gëzim Gjoshi P.nr. 10/22 të dt. 24.01.2021.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbaruesit Privat, P.nr. 10/2022 i datës 17.01.2022, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv), Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.207/17 i datës 23.10.2018, i formës së prerë nga data 21.07.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 31.08.2021.

Sipas dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr. 207/17 i datës 23.10.2018, kreditorit i është pranuar kërkesëpapia pjesërisht dhe është detyruar debitori që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 7,320.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 23.10.2018, e deri në pagesën definitive, si dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 100 €, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarimor Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr. 207/17 i datës 23.10.2018, i formës së prerë nga data 21.07.2021 dhe ekzekutueshëm nga data 31.08.2021, është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr. 207/17 i datës 23.10.2018, është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditorët dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 213 të LPK –së, është përcaktuar se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*. Andaj fakti se debitori ka parashtruar revizion nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

Gjykata po ashtu gjen se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë as me parashkrim të kërkesave të vërtetuara nga gjykata me vendim të formës së prerë, pasi që bazuar në dispozitën e nenit 361 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me të cilën përcaktohet se *“ Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.”*, rezulton se propozimi për përmbarim është paraqitur brenda afatit dhjetë (10) vjeçar të përcaktuar si më lartë, pasi që Urdhri Përmbarimor P.nr.10/2022 është lëshuar me datën 17.01.2022, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.207/17 i datës 23.10.2018, ka marrë formën e prerë me datën 21.07.2021 dhe është bërë i ekzekutueshëm prej datës 31.08.2021.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1794/22, datë 29.09.2022

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.